



Përveç ofrimit të shërbimeve dhe produkteve bankare, Raiffeisen Bank në Kosovë është e përkushtuar të kontribuojë edhe në përkrahjen e projekteve të ndryshme të komunitetit në rajonin ku vepron, si pjesë e përgjegjësisë së saj sociale. Gjatë vitit 2010, Raiffeisen Bank ka sponsoruar dhe ka ofruar donacione për projekte të ndryshme në fushën e kulturës, arsimit, sportit, mirëqenies sociale.

Raiffeisen Bank fton të gjitha palët e interesuara që të sjellin projektet që do të realizohen gjatë vitit 2011 dhe të cilat i takojnë kategorive të dhëna në vijim:

- **Arsim**
- **Kulturë**
- **Sport**
- **Mirëqenie sociale**
- **Fëmijë dhe të rinj**

Kërkesat për sponsorim të projekteve duhet të dorëzohen nga institucione dhe organizata të ndryshme që veprojnë në Kosovë të cilat konsiderojnë se përkrahja e Raiffeisen Bank do të ishte e nevojshme për t'i realizuar projektet e tyre. Kërkesa duhet të përmbajë një përshkrim të qartë të projektit, duke përfshirë këtu planet dhe synimet si dhe periudhën gjatë vitit 2011 kur projekti parashihet të realizohet.

Palët e interesuara duhet t'i dorëzojnë kërkesat në zarf të mbyllur në adresën:

**Raiffeisen Bank në Kosovë**  
**Departamenti i Marketingut dhe Marrëdhënieve me Publik**  
**(Kërkesë për sponsorim 2011)**  
**Rruga Eqrem Qabej, No. 8** (përballë Sallës së sportit "1 Tetori")  
**Prishtinë, Kosovë**

Dita e fundit për dorëzimin e projekteve është **e hënë, 6 shtator 2010, ora 12:00.**

Projektet do të shqyrtohen nga komisioni Raiffeisen Bank ndërsa palët do të njoftohen për rezultatin e tyre brenda 30 ditëve pas afatit të fundit për dorëzimin e projekteve.

### **Shënim:**

Projektet e dorëzuara nuk kthehen.  
Projektet individuale nuk do të konsiderohen.

Për informacione tjera, ju lutem vizitoni web faqen e Raiffeisen Bank në Kosovë:  
[www.raiffeisen-kosovo.com](http://www.raiffeisen-kosovo.com).